



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 78

9 korrik

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.412, datë 2.7.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr.782, datë 10.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komisionit Shtetëror, për organizimin e veprimtarive festive “Viti i 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”, të ndryshuar	3589
Vendim i KM nr. 414, datë 27.6.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr.1 114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	3589
Udhëzim i MPPT nr. 5, datë 28.3.2012	Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR	3592

VENDIM
Nr.412, datë 2.7.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.782, DATË 10.11.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR, PËR ORGANIZIMIN E
VEPRIMTARIVE FESTIVE “VITI I 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2 të vendimit nr.782, datë 10.11.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Zëvendëskryeministrin dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;”

- Shkronja “a” zëvendësohet me “a/1” dhe ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ a/1. Ministrin e Punëve të Jashtme;”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 414, datë 27.6.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1 114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703, DATË
11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR, NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, DHE SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR
SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1 114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 91 475 (nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13 të kreut III, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 5 104 (pesë mijë e njëqind e katër) lekë.

Kontributi minimal sipas degëve të sigurimit të jetë:	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	55;
Dega e sigurimit të barrëindjeve	1.4	256;
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	3 952;
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	55;
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	165;
Sigurimet shëndetësore	3.4	622.

2. Shuma mininale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e papaguar të familjes, që jetojnë e punojnë me të vetëpunësuarin, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 280 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë.

...

6. I vetëpunësuar, i vetëpunësuar në ortakëri, i vetëpunësuar që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2012 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind, sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, të barabartë me 5 488 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

7. I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2012 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, të barabartë me 5 488 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

...

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 2 250 (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.7.2012 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 20 400 (njëzet mijë e katërqind) lekë.

...

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore për personat, që punojnë si punëtor shtëpie, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 2 250 (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.”.

3. Pika 6 e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore furnizon punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit me librezat e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore. Punëdhënësi pajis të punësuarit e tij me librezën e kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, dhe i plotëson ato çdo muaj në datën e pagesës së pagës mujore. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes të patrajtuar me pagë, si dhe për punëmarrësit e punësuar te i vetëpunësuarit, që ka statusin “i vetëpunësuar me punëmarrës”, librezat e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat lokale, të autorizuar, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të vjetërsisë në punë, për të përfituar pension të pjesshëm sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të kryejnë pagesa kontributesh edhe pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t’u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension.

Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2012 e në vazhdim, pavarësisht se mund të jenë të pasiguar për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen periudha sigurimi.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t’u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t’i paguajnë kontributet me kuotat e vitit përkatës, së bashku me kamatëvonesat e llogaritura.”.

4. Pika 9 e kreut V ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Në tremujorin pasardhës të vetëpunësuarit, pjesëtarët e papaguar të familjes, punëmarrësit e punësuar te i vetëpunësuarit, që ka statusin “i vetëpunësuar me punëmarrës”, të vetëpunësuarit në veprimtari ambulante dhe të vetëpunësuarit në bujqësi vlerësohen të siguruar, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës brenda afateve të përcaktuara me ligjin nr.7703, datë 1.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Kreu VIII ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU VIII

SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 11 562 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit, për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 7 841 (shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 27, të pikës 2 të nenit 59 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për barrëlindje, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë gjatë gjithë muajve të vitit të fundit kalendarik, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale të përcaktuara, për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12 muaj.

4. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuar në bujqësi, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 7 841 (shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë në muaj.



5. Në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si pagë neto për periudhat e punës përpara datës 1.10.1994 vlerësohet të jetë shuma që del pasi, nga paga referuese e përcaktuar me vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e pagës referuese për llogaritjen e pensioneve”, zbritet tatimi mbi të ardhurat personale, i përcaktuar me ligjin nr. 7585, datë 14.7.1992 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 5, datë 28.3.2012

**PËR EKZAMINIMIN E MJETEVE DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E
CERTIFIKATËS SË MIRATIMIT ADR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, neneve 57 dhe 63 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”, dhe kapitullit IX të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 21.8.1998 “Për rregullat e klasifikimit, emërtimit dhe transportit rrugor të mallrave të rrezikshme”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

KREU I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është implementimi i marrëveshjes europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe direktivës 2008/68 “Mbi transportin e brendshëm të mallrave të rrezikshme”.

2. Me anën e këtij udhëzimi përcaktohen e procedurat e ekzaminimit të mjeteve dhe të lëshimit të certifikatës së miratimit ADR për mjetet që kryejnë transport rrugor të mallrave të rrezikshme.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim do të zbatohet për mjetet e transportit të mallrave të kategorive N dhe O me masë maksimale të lejuar që i kalon 3,5 tonët.

2. Ky udhëzim është i vlefshëm për mjetet që kryejnë transport rrugor, ndërkombëtar e të brendshëm të mallrave të rrezikshme.

3. Ky udhëzim nuk zbatohet për transportin e mallrave me mjete:

a) që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; ose

b) që operojnë brenda perimetrit të një zone të mbyllur, ku mallrat mund të prodhohen, trajtohen, përpunohen, ruhen, sistemohen apo transferohen në hapësirën e brendshme.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllime të këtij udhëzimi, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

“ADR” nënkupton ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen europiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”.

“Direktiva 2008/68” nënkupton direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës e 24 shtatorit 2008 “Mbi transportin e brendshëm të mallrave të rrezikshme”.

“Dita e caktuar” nënkupton ditën e caktuar për kryerjen e:

a) ekzaminimit të mjetit;

b) ritestimit (rikontroll teknik) të mjetit.

“Ekzaminues i autorizuar” nënkupton personin e caktuar ose të autorizuar nga DPSHTRR-ja për ekzaminimin e testimit të mjeteve rrugore, sipas nenit 5 të këtij udhëzimi.

“Miratimi i tipit të mjetit” nënkupton çdo mjet, i cili është miratuar në përputhje me udhëzimin nr. 11, datë 6.6.2011 “Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, të pjesëve përbërëse dhe njësisive të veçanta teknike të destinuar për këto mjete”.

“Miratimi i ADR-së” nënkupton certifikatën e lëshuar nga DPSHTRR-ja që një mjet i vetëm i destinuar për transportin e mallrave të rrezikshme, i cili kënaq kërkesat teknike përkatëse të pjesës 9 të ADR-së për mjetet EX/II, EX III, FL, OX ose AT.

“Mjet i plotë” nënkupton çdo mjet, i cili nuk kërkon plotësime të mëtejshme konstruktive (d.m.th. një fazë e ndërtimit të kamionit, tërheqësit, rimorkios).

“Mjet jo i plotë” nënkupton çdo mjet, i cili ka nevojë për plotësime konstruktive në një fazë të mëtejshme (d.m.th. shasi-kabinë, shasi-rimorkio).

“Mjet i plotësuar” nënkupton çdo mjet, i cili është rezultat i një procesi shumëfazësh (d.m.th. i përshtatur me një strukturë të jashtme shasi ose shasi-kabinë).

“Pronar i mjetit” nënkupton personin, në emër të të cilit mjeti është i regjistruar dhe, për sa i përket një mjeti i cili është subjekt i blerjes me këste ose sipas një marrëveshjeje me *leasing*, nënkupton personin në zotërim të mjetit, sipas një marrëveshjeje të tillë.

“Ritestim” nënkupton ekzaminimin pasues të një mjeti, sipas kreut II të këtij udhëzimi, në vijim të refuzimit të certifikatës së miratimit të mjetit në lidhje me këtë mjet, ku ritestimi kryhet brenda 14 ditëve pas ditës në të cilën certifikata e miratimit të mjetit është refuzuar.

“Kontrolli teknik i mjeteve rrugore (KTV)” nënkupton kontrollin teknik vjetor (KTV) të mjeteve rrugore, të kryer sipas udhëzimit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 2, datë 11.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve”.

KREU II EKZAMINIMI I MJETIT PËR CERTIFIKATËN E MIRATIMIT ADR

Neni 4

1. Pronari i mjetit të plotë ose të plotësuar, i cili operon në transportin e mallrave të rrezikshme, aplikon për certifikatën e miratimit ADR të mjetit në Drejtorinë e Kontrollit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).



2. Aplikimi konsiderohet i pranuar, pasi pronari i mjetit ka plotësuar formularin, modeli i të cilit është paraqitur në aneksin 2 të këtij udhëzimi, ka paguar detyrimet financiare, dhe ka shoqëruar me kopjet e dokumenteve të nevojshme, të specifikuara në nenin 6 të këtij udhëzimi.

3. Pasi aplikimi është pranuar, ekzaminuesi i autorizuar kryen ekzaminimin e mjetit për të provuar plotësimin e kërkesave në lidhje me konstruksionin dhe miratimin e mjetit, siç kërkohet për t'u testuar në pjesën 9 të marrëveshjes ADR, përkundrejt klasave të mallrave të rrezikshme, të cilat janë përcaktuar në kërkesë.

4. Ekzaminimi kryhet edhe në rastin e ndonjë ritestimi të një mjeti, por në këtë rast, ai kryhet vetëm për ato pjesë ose nyje e detaje, për shkak të të cilave certifikata e miratimit ADR të mjetit është refuzuar.

5. Ekzaminuesit e autorizuar duhet të jenë individë të kualifikuar, të cilët kanë përfunduar shkollën e lartë të inxhinierisë mekanike.

Neni 5

1. Në vijim të ekzaminimit të mjetit, sipas nenit 4, kur një ekzaminues i autorizuar konstaton se mjeti plotëson kërkesat e pjesës 9 të ADR-së:

a) i lëshon pronarit të mjetit, në emër të DPSHTRR-së, certifikatën e miratimit të mjetit që u ekzaminua;

b) dorëzon një kopje të certifikatës së lëshuar, sipas shkronjës "a" të kësaj pike në Drejtorinë e Kontrollit Teknik.

2. Nëse ekzaminuesi i autorizuar gjatë ekzaminimit të mjetit konstaton se mjeti nuk plotëson kërkesat e pjesës 9 të ADR-së, ai i jep pronarit të mjetit një raport në lidhje me ekzaminimin e mjetit.

3. Certifikata e miratimit e lëshuar sipas shkronjës "a" të paragrafit 1 ose raporti i lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, firmosen nga drejtori i kontrollit teknik ose i autorizuari nga drejtori i DPSHTRR-së.

4. Modeli i certifikatës së miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar është në përputhje me nënseksionin 9.1.3 të marrëveshjes ADR i paraqitur në aneksin 3 të këtij udhëzimi.

5. Në dallim nga certifikata e miratimit ADR për transportin ndërkombëtar, për mjetet në transportin brenda vendit të mallrave të rrezikshme përdoret i njëjti format dhe me të njëjtën përmbajtje, por i mungon shiriti diagonal ngjyrë rozë, aneksi 4.

Neni 6

Dokumentet për ekzaminim

1. Ekzaminimi i mjetit sipas nenit 4, nuk kryhet nëse pronari i mjetit nuk paraqitet në ditën e caktuar për kryerjen e kontrollit të mjetit, së bashku me dokumentet origjinale:

a) certifikatën e kontrollit teknik vjetor të mjetit, sipas udhëzimit nr. 2, datë 11.3.2010;

b) certifikatën/dëshminë e pronarit ose operatorit, ose të autorizuarit të personit fizik ose juridik, sipas modelit të së cilës jepet në aneksin 1 të këtij udhëzimi, që mjeti është i sigurt për ekzaminim, dhe në rastin e një mjeti-cisternë, dëshmia tregon që cisterna është e pastër dhe e sigurt;

c) certifikatën e kontrollit të cisternës për transportin e mallrave të rrezikshme për cisternat, sipas modelit 013 të udhëzimit nr. 749, datë 28.12.1999.

2. Data e fundit për të kryer një ekzaminim të mjetit sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4, është 15 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit në Drejtorinë e Kontrollit Teknik të DPSHTRR-së.

3. Kur një ekzaminim i mjetit sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 nuk është kryer në datën e fundit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, ekzaminuesi i autorizuar duhet të kthejë dokumentacionin, përfshirë certifikatën e miratimit të mjetit, te Drejtoria e Kontrollit Teknik sipas paragrafit 3 të nenit 4 i autorizuar jo më vonë se 5 ditë nga data e fundit.

4. Kushti sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk do të zbatohet, kur periudha ndërmjet datës së regjistrimit të parë të mjetit dhe datës së caktuar është më e vogël se një vit.

Neni 7

Refuzimi për kontrollin e mjetit

Një ekzaminues i autorizuar refuzon pranimin për ekzaminimin e mjetit për arsye:

- a) të ndonjë pjese ose ndonjë prej pajisjeve të tij është e ndotur ose e rrezikshme që e bëjnë të vështirë kryerjen e ekzaminimit; ose
- b) të ngarkesës me mallra të rrezikshme mbi mjet.

Neni 8

Një ekzaminim i mjetit të plotë ose të plotësuar për përfundimin e certifikatës së miratimit ADR, nuk kryhet:

- a) për arsye të mosplotësimit të një kërkesë të nenit 6 të këtij udhëzimi; ose
- b) për arsye të refuzimit në pranimin e mjetit sipas nenit 7 të këtij udhëzimi.

Neni 9

1. Një certifikatë e miratimit ADR të një mjeti të plotë ose të plotësuar, e lëshuar sipas paragrafit 1 të nenit 5 të këtij udhëzimi pas përfundimit të një ekzaminimi, është e vlefshme:

- a) subjekt te shkronjat “b” dhe “c” të këtij paragrafi, për periudhën prej një viti nga data e lëshimit të certifikatës së miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar;
- b) subjekt te shkronja “c”, në rastin e një mjeti me certifikatën aktuale të miratimit ADR, të mjetit të plotë ose të plotësuar, e cila përfundon më pak se 30 ditë në vijim të datës së përfundimit të një ekzaminimi sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 5, për një periudhë prej një viti nga data e shfuqizimit të certifikatës aktuale të miratimit ADR; ose
- c) në rastin kur, sipas rregullave të udhëzimit nr. 749, datë 28.12.1999, cisterna e një mjeti-cisternë duhet t’i nënshtrohet një kontrolli periodik, një kontrolli të plotë, një kontrolli periodik të ndërmjetëm ose një kontrolli të mosrjedhjes, në më pak se një vit nga data e përfundimit të ekzaminimit sipas paragrafit 3 të nenit 4 të këtij udhëzimi, për periudhën nga data e saj e lëshimit në datën e përfundimit (shfuqizimit) të certifikatës së testit periodik të cisternës ose certifikatës së testit të mosrjedhjes së cisternës, cilido që prej këtyre përfundon më shpejt.

2. Një certifikatë për kontrollin periodik, kontrollin e plotë, kontrollin e ndërmjetëm ose kontrollit të mosrjedhjes ose kontrollit të valvulave të sigurimit, i kryer pas lëshimit të certifikatës së miratimit ADR të mjetit, e përcaktuar në përputhje me shkronjën “c” të paragrafit 1 të këtij neni dorëzohet te personi i caktuar sipas paragrafit 3 të nenit 5, i cili mund të shtrijë, me pagesën e detyrimeve, vlefshmërinë e certifikatës së miratimit të mjetit-cisternë për një periudhë që përfundon një vit nga data e përfundimit të ekzaminimit të mjetit sipas paragrafit 3 të nenit 4.



Neni 10

Zëvendësimi i certifikatës së miratimit ADR të mjetit

1. Kur certifikata e miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar ka humbur, është shkatërruar ose është prishur pjesërisht, personi i caktuar sipas paragrafit 3 të nenit 5 mund të lëshojë një certifikatë zëvendësuese, e cila të përmbajë dukshëm shënimin “ZËVENDĖSUESE”.

2. Kur një certifikatë e miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar e lëshuar sipas nenit 5 është bërë e palexueshme, ose ngjyra e certifikatës ka ndryshuar nga ndonjë veprim ose pakujdesi nga zotëruesi i certifikatës, personi i caktuar sipas paragrafit 3 të nenit 5 mund të lëshojë një certifikatë zëvendësuese, e cila të përmbajë dukshëm shënimin “ZËVENDĖSUESE”.

Neni 11

Regjistrimi i certifikatës

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor regjistron në një regjistër me shkrim dhe elektronik, dhe dokumenton të gjitha veprimet që kryhen për mjetet e transportit të mallrave të rrezikshme për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR të mjetit. Ajo i jep informacion vetëm ministrisë dhe organeve të caktuara me ligj.

Neni 12

Anulimi i certifikatës së miratimit ADR të mjetit

1. Organet e kontrollit në rrugë mund të anulojnë një certifikatë të miratimit ADR të mjetit nëse ka arsye të forta të besojnë që certifikata e lëshuar është e pasaktë ose e pavlefshme. Në këtë rast, certifikata e miratimit ADR të mjetit dorëzohet brenda 7 ditëve në DPSHTRR nga pronari i mjetit, të cilit i përket kjo certifikatë, ose mbajtësi i certifikatës.

2. Nëse organet e kontrollit në rrugë anulojnë një certifikatë të miratimit ADR të mjetit, ata tërheqin certifikatën e miratimit ADR të mjetit dhe brenda 7 ditëve e dorëzojnë në DPSHTRR.

3. Rastet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 mbahen shënime të duhura në regjistrin përkatës.

Neni 13

Ndalimi kundër përdorimit të një mjete pa qenë i pajisur me certifikatën e miratimit ADR

Asnjë person nuk përdor një mjet, tek i cili dispozitat e ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, kapitullit 9.1 të marrëveshjes ADR dhe të këtij udhëzimi zbatohen për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë, nëse ky mjet nuk ka një certifikatë të vlefshme të miratimit ADR në fuqi.

Neni 14

1. Certifikata e miratimit ADR të mjetit nuk është e vlefshme për një mjet po të mos shoqërohet me certifikatën e kontrollit teknik në fuqi të vetë mjetit, e lëshuar sipas udhëzimit nr. 2, datë 11.3.2010.

Neni 15

Mjetet për transportin e brendshëm

1. Mjetet për transportin e mallrave të rrezikshme EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT, të prodhuara ndërmjet 30 qershorit 1993 dhe 1 janarit 1997 në shtetet anëtare të BE-së, në përputhje me kërkesat kombëtare në fuqi deri më 31 dhjetor 1996 të këtyre shteteve, por që nuk përputhen me kërkesat e ADR-së, lejohen të përdoren në transportin e mallrave të rrezikshme brenda vendit, me kusht që këto mjete të plotësojnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Në këtë rast, kujdes i veçantë duhet të tregohet në lëshimin e certifikatës së miratimit ADR për herë të parë.

2. Gjatë ekzaminimit të mjeteve, subjekt të paragrafit 1 i këtij neni, kryhet verifikimi nëse mjetet motorike dhe rimorkiot e gjysmërimorkiot janë në përputhje me nënseksionin 9.2.3.1.

3. Nëse verifikimi i kryer sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk është pasqyruar në dokumentet shoqëruese të mjetit, prodhuesi i mjetit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij i njohur nga DPSHTRR-ja, lëshon një deklaratë të konformitetit në përputhje me paragrafin e fundit të nënseksionin 9.1.2.1: “Kur mjeteve u kërkohet të përshtaten me sistemimin e rezistencës në frenim (zgjatje e frenimit), prodhuesi i mjetit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij lëshojnë një deklaratë të konformitetit me përshkrimet përkatëse të aneksit 5 të rregullores nr. 13/ ECE. Kjo deklaratë paraqitet në inspektimin e parë teknik”.

Neni 16

Mjetet për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme

Në transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme lejohen të përdoren mjetet EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT, të cilat janë prodhuar pas 1 janarit 1997 dhe ekzaminimi i tyre tregon se plotësojnë kërkesat e kapitujve 9.2-9.8 të marrëveshjes ADR.

Neni 17

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të publikojë në faqen e saj të internetit pjesën 9 “Kërkesat në lidhje me konstruksionin dhe miratimin e mjetit” të ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen europiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”.

Neni 18

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



Aneksi 1, certifikata për mjetet, të cilët transportojnë mallra ose substanca të rrezikshme
Faqe e përparme

Logo

formati A4
DPSHTRR

CERTIFIKATA PËR MJETET QË TRANSPORTOJNË MALLRA TË RREZIKSHME OSE LËNDË TË RREZIKSHME

Të dorëzohet kur mjete i mallrave që përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme arrin për testim në Qendrën e Testimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Para plotësimit të kësaj certifikate, ju lutem lexoni të gjitha shënimet prapa.

Përcaktimi i mjetit dhe i ngarkesës

Marka e regjistrimit të mjetit ose marka e identifikimit të rimorkios (nëse nuk ka numër regjistrimi ose markë identifikimi, ju lutem regjistroni numrin e shasisë).

--

Numri dhe klasifikimi sipas UN (shih prapa) i lëndës së fundit apo aktuale të transportuar me mjet/rimorkio

Numri sipas UN	Klasifikimi i rrezikut	
	Kryesor	Dytësor

Deklarata A

Deklaroj se informacioni i dhënë më lart (informacioni për mjetin dhe ngarkesën) është i saktë.

Vërtetoj se mjete i përmendur më lart është pastruar dhe është i sigurt për ekzaminim nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Nënshkroi Emri.....
Emri i kompanisë Data

Pozicioni në biznes..... Nr. i tel

Tani plotësoni deklaratën A ose deklaratën B.

Deklarata B

Deklaroj se informacioni i dhënë më lart (informacioni për mjetin dhe ngarkesën) është i saktë.

Vërtetoj se kam lexuar shënimet prapa dhe kam marrë të gjitha masat e duhura paraprake në lidhje me mjetin e përmendur më lart, për të qenë i sigurt për ekzaminim nga Qendra e Kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor më (data).

Nënshkroi Emri

Emri i kompanisë Data

Pozicioni në biznes.....Nr. i tel.....

JU LUTEMI SHËNONI: Për çdo testim ose ritestim vijues, duhet të paraqitet një certifikatë e re.

Aneksi 1, faqe e pasme

PËRGATITJA E MJETIT TË PËRDORUR PËR TRANSPORTIN E NGARKESAVE TË RREZIKSHME PËR TESTIN E AUTOMJETIT TË MALLRAVE

1. Para dërgimit të automjetit tuaj për test në Qendrën e Kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ju lutem lexoni shënimet e mëposhtme dhe kryeni punën e nevojshme parapërgatitore që automjeti të jetë i sigurt për testim.

2. Për të gjitha rastet, numri i UN dhe klasifikimi i lëndës që mjete ka mbartur udhëtimin e fundit të lëndës së transportuar, duhet të deklarohet në faqen parë. Mjeti duhet të shoqërohet, gjithashtu, nga një person që ka kualifikimin e trajnimit përkatës të dëshminë e ADR, të zbatueshëm për mallrat e rrezikshme të transportuara.

3. Sigurohuni që certifikata në pjesën e parë të këtij formulari është nënshkruar nga një nëpunës përgjegjës pas përfundimit të përgatitjeve. Kjo është e nevojshme në të gjitha rastet, edhe nëse mjeti nuk ka transportuar asnjë mall të rrezikshëm menjëherë para testit dhe mbart asnjë mall të rrezikshëm gjatë testit. Certifikata e nënshkruar duhet të paraqitet pas mbërritjes në Qendrën e Kontrollit. Pa këtë dokument testi nuk kryhet.

4. Drejtuesi i Qendrës së Testimit nuk do të pranojnë në asnjë rrethanë mjete të paraqitura për testim, të cilat janë të ngarkuara ose të ngarkuara pjesërisht me mallra të rrezikshme.

Aneksi 2: Aplikimi për marrjen e certifikatës së miratimit të një mjeti rrugor dhe deklaratat mjetit

formati A4
Logo DPSHTRR

APLIKIMI PËR CERTIFIKIMIN E MJETIT RRUGOR SIPAS ADR-SË

Lexo shënimet në pjesën e pasme të këtij formulari para plotësimit të këtij aplikimi.

PJESA 1 (të plotësohet nga të gjithë aplikuesit)

1. APLIKUESI

Emri i kontaktit: _____ nr. i tel: _____

Kompania: _____

Adresa: _____ kodi postal: _____

2. MJETI (ju lutem shënoni kutinë e duhur)

A është ky aplikimi i parë për këtë automjet? PO JO

Lloji i mjetit	Traktor i artikulluar <input type="checkbox"/>	I ngurtë <input type="checkbox"/>
Rimorkio me aks në qendër <input type="checkbox"/>	Rimorkio e plotë me krah lidhës <input type="checkbox"/>	Gjysmërimorkio <input type="checkbox"/>
A është ky mjet i lehtë mallrash d.m.th. TPL 3001 kg deri 3500 kg?		PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>
Metoda e transportimit ose mbajtjes së ngarkesës	Konstruksion (i mbyllur) me kuti <input type="checkbox"/>	Skeletore <input type="checkbox"/>
	Ngarkesë e veshur me shtresë <input type="checkbox"/>	Enë e mjetit-bateri <input type="checkbox"/>
	Cisternë <input type="checkbox"/>	

Marka e regjistrimit ose nr. ID i rimorkios: _____ prodhimi i mjetit/rimorkios _____

Nr. i shasisë së mjetit/rimorkios: _____ nr. i akseve: _____

Vetëm për aplikimet e para të mjetit me motor: A e ka mjeti miratimin e tipit sipas ADR-së? PO JO

Nëse po, ju lutem shënoni numrin e miratimit të tipit sipas ADR-së dhe renditni çdo ndryshim që i është bërë mjetit që nga miratimi i tipit:



Numri ADR T/A _____ ndryshimet _____

Për cisternat fikse dhe mjetet-bateri:

Viti i prodhimit: _____ nr. cert. TC2 cert. Nr: _____

Prodhuesi i cisternës: _____ nr. i serisë së cisternës: _____

Identifikimi i elementeve-bateri: _____ ose shih listën bashkëngjitur: (shëno)

Kodi i cisternës (ADR 4.3.3.1/4.3.4.1): _____ Dispozitat speciale (ADR 6.8.4/ shënimi 11(e)) _____

3. PRONARI/OPERATORI I MJETIT (të plotësohet nga të gjithë aplikuesit)

Kompania: _____

Adresa: _____

_____ kodi postal: _____

4. TESTI

